

Vjenë, 2.9.2020

Shumë të nderuar prindër, shumë të nderuar persona me të drejtë kujdestarie
(Erziehungsberechtigte)!

Pas një vere të pazakontë, me shpresë se ju ka sjellë edhe pak çlodhje, po rikthehet me fillimin e vitit të ri shkollor një pjesë e normalitetit në jetën e përditshme të fëmijëve dhe të të rinjve. Siç e kemi theksuar shpesh, ne dëshirojmë fort që t'ua bëjmë të mundur nxënësve e nxënësve, pedagoqeve e pedagogëve, por edhe juve, një frekuentim sa më të rregullt të mësimin në vitin e veçantë shkollor 2020/21, megjithë sfidat që sjell me vete virusi korona. Masat, me anë të të cilave së bashku mund ta përballojmë këtë, dëshirojmë t'i skicojmë në këtë letër dhe njëkohësisht t'ju lusim përsëri për ndihmën tuaj.

Kushte të qarta dhe rregulla higjenike për shkollat dhe institucionet që kujdesen për fëmijë

Që prej mesit të gushtit Ministria Federale e Arsimit, Shkencës dhe Hulumtimit Shkencor ua ka bërë të qartë të gjitha shkollave austriake kushtet bazë për vitin e ri shkollor. Këto përfshijnë midis të tjerash një plan të qartë për higjenën dhe parandalimin, si dhe një udhëzues që tregon se çka duhet bërë gjatë një dite shkollore në fazat e ndryshme të Semaforit Korona, që ka vënë në zbatim Ministria e Shëndetësisë. Sa u përket parapërgatitjeve të tjera, ne jemi vazhdimisht duke komunikuar me këshilltarët përkatës të landeve dhe institucionet shëndetësore, si dhe drejtoritë arsimore e shkollat.

Sjellje me përgjegjësi të plotë ndaj simptomave të mundshme të Covid-19 dhe sëmundjeve të tjera – zgjatje e kohës së jashtëzakonshme të kujdestarisë (Sonderbetreuungszeit)

Pjesë e "Shkollës në vjeshtë" janë edhe temperaturat në rënie – periudha e sëmundjeve si pasojë e ftohjeve pret para derës. Secili prej nesh i di tashmë simptomat kryesore të COVID-19, të cilat pjesërisht nuk dallohen qartë prej atyre të një ftohjeje të zakonshme. Sëmundja me COVID-19 mund të kalojë edhe pa simptoma.

Nuk ka kuptim që të kërkohet prej jush si prindër e persona me të drejtë kujdestarie, që të mos ta çoni fëmijën tuaj në shkollë për shkak të një rrufe. Por ajo çka ne megjithatë kërkojmë prej jush është që ta vrojtoni me imtësi gjendjen shëndetësore të fëmijës suaj dhe në rast dyshimi ta mbani në shtëpi. Një tregues i rëndësishëm në këtë aspekt është shfaqja e temperaturës, domethënë ngritja e temperaturës. Kur fëmija juaj ka simptomat e një infeksioni (si kollë, dhimbje fyti ose koke), ju lutemi t'i matni patjetër para se të vijë në shkollë temperaturën. Kur temperatura e trupit është më e lartë se 37,5 gradë, duhet hequr dorë nga dërgimi në shkollë.

Ne e kemi të qartë se vendimi për ta çuar fëmijën në shkollë ose për ta lënë në shtëpi për shkak të simptomave, është një përlllogaritje e vështirë. Ky vendim ju vendos ju si nëna, etër dhe persona

me të drejtë kujdestarie para vështirësish edhe sa i takon bashkërendimit të punës me familjen. Ju si prindër dhe persona me të drejtë kujdestarie e njihni më mirë se kushdo tjetër fëmijën ose fëmijët tuaj, prandaj mund të jepni një kontribut të rëndësishëm për të ndaluar përhapjen e sëmundjeve infektive. Për t'ju mbështetur në këtë aspekt do të zgjatet deri në shkurt të vitit 2021 e drejta ekzistuese për leje të veçantë kujdestarie (Sonderbetreuungszeit). Në këtë mënyrë, prindërit dhe personat me të drejtë kujdestarie kanë sërish mundësi të marrin për fëmijët e tyre leje kujdestarie të veçantë deri në tre javë pa humbur pagesën, pavarësisht nëse e kanë konsumuar një herë këtë në gjysmën e parë të këtij viti.

Të reduktojmë në përgjithësi sëmundjet – pjesëmarrje në programet gratis të vaksinimit

Një sistem imunitar i shëndetshëm të mbron prej sëmundjeve. Reduktimi i sëmundjeve me simptoma të ngjashme me koronën na ndihmon jashtëzakonisht që ta jetojmë çdo ditë të shkollës me më pak shqetësim dhe merak. Vaksinat parandaluese luajnë në këtë rast një rol të rëndësishëm. Të gjithë fëmijët deri në moshën 15 vjeçare, që jetojnë në Austri, mund të bëjnë vaksinime të caktuara pa pagesë. Për herë të parë, këtë vit shkollor do të ofrohet edhe vaksinim gratis kundër influencës. Ne ju rekomandojmë që ta shfrytëzoni këtë ofertë.


Kini besim te shkolla dhe institucioni juaj kujdestar

Blllokimi i infeksioneve të tipit korona, rëndësia e arsimimit dhe domosdoshmëria për të kryer profesionin përkatës – harmonizimi i të gjithë këtyre është i vështirë dhe krijon marrëdhënie të tensionuara. Ju, së bashku me fëmijën apo fëmijët tuaj dhe pedagogët në shkollë formoni një ekip të rëndësishëm. Kur të jetë fjala për të përcaktuar sjelljen “më të mirë” ndaj COVID-19, disa herë mendimet nuk do të përputhen. Por ajo çka na bashkon është besimi se këtë krizë do ta përballojmë së bashku, duke pasur mirëkuptim për shqetësimet dhe frikën e njëri-tjetrit.

Ne ju falenderojmë ju dhe fëmijët tuaj!



Juaji Heinz Faßmann
Ministër për Arsimin, Shkencën
dhe Hulumtimin shkencor



Juaja Christine Aschbacher
Ministre për Punën, Familjen dhe
Rininë

Për çdo pyetje ju lutemi të drejtoheni te numrat përkatës telefonikë për koronën (Corona-Hotlines) të BMBWF dhe të Drejtorive Arsimore (Bildungsdirektionen):

www.bmbwf.gv.at/hotlines_schule

Të gjitha informacionet për prindërit lidhur me organizimin e „Shkollës në vjeshtë“ i gjeni këtu:

www.bmbwf.gv.at/elterninfo

Për pyetjet lidhur me lejen e veçantë të kujdestarisë gjeni informacione më të hollësishme në linkun e mëposhtëm:

<https://www.bmafj.gv.at/Services/News/Coronavirus/FAQ-Sonderbetreuungszeit.html>

Përkthim i së njëjtës dosje në gjermanisht për prindërit dhe personat me të drejtë kujdestarie

Gemeinsam gegen Corona! Schule im Herbst 2020

Së bashku kundër koronës! Shkolla në vjeshtën e vitit 2020

Shumë të nderuar prindër, shumë të nderuar persona me të drejtë kujdestarie (Erziehungsberechtigte)!

Këtu gjeni të përmbledhura informacione, masa dhe oferta, që synojnë t'ju ndihmojnë ju dhe fëmijën tuaj në vitin e veçantë shkollor 2020/21.

Ministria për Arsimin, Shkencën dhe Hulumtimin shkencor (BMBWF)

Çfarë përgatitjesh ka bërë shkolla ime për vitin shkollor 2020/21?

Çdo shkollë është informuar nga BMBWF se me cilat masa mund të mbrohesh në shkollë nga rreziku i infektimit me COVID-19 dhe çfarë duhet bërë në fazat e ndryshme të Semaforit për koronën.

www.bmbwf.gv.at/schuleimherbst

Kush do të më informojë mua për fazën e Semaforit në shkollën time dhe çfarë duhet të bëj unë?

Ju do të informoheni nga drejtorja e shkollës ose nga ekipi i krizës në shkollën tuaj. Semafori përmban fazat e gjelbër, e verdhë, portokalli dhe e kuqe. Si bazë shërben ngjyra e gjelbër, pra zhvillim i rregullt i mësimin. Gjatë ngjyrës së verdhë dhe portokalli zbatohen masa të mëtejshme parandaluese, të cilat kanë kryesisht si qëllim që të ndalojnë “kontaktet e reja” dhe kontaktin për një kohë të gjatë midis njerëzve. Kur është faza e kuqe, kalohet përsëri në mësimin online nga shtëpia (Distance Learning).

www.bmbwf.gv.at/coronaampel

Si do t'i vihen në dispozicion fëmijës tim materialet mësimore në rastet kur shkolla mbyllet përkohësisht?

Në përgjithësi çdo shkollë punon me një portal mësimor digjital të caktuar dhe nëpërmjet tij do ta vazhdojë edhe mësimin. Në shkollat fillore do të zbatohet kryesisht edhe më tej një përzierje midis materialeve të shtypura dhe atyre me përmbajtje digjitale.

A mund ta furnizoj edhe unë fëmijën tim me materiale mësimore digjitale?

Po! Në Eduthek mund të gjeni ushtrime të shumta për çdo moshë dhe çdo klasë.

www.eduthek.at

Çfarë mund të bëj unë që në shkollën e fëmijës sime të mos ketë infektim me COVID-19?

- Forconi sistemin imunitar të fëmijës suaj (ushqim të shëndetshëm, lëvizje në natyrë etj.).
- Vrojtoni gjendjen shëndetësore të fëmijës suaj.
- Lëroni fëmijën tuaj në shtëpi kur ka temperaturë.
- Edhe kur fëmija juaj ka njëkohësisht disa simptoma të ngjashme me koronën, si kollë, dhimbje fyti, dhimbje koke ose humbje të shqisës së nuhatjes apo shijes, nuk duhet ta çoni në shkollë.
- Nëse dyshoni, në bazë të simptomave, se fëmija juaj mund të jetë i sëmurë me korona, ju lutemi të telefononi 1450 dhe të informoni shkollën e tij.
- Lejoeni fëmijën tuaj që të marrë pjesë në programin e vaksinimit.
- Shumë vaksinime parandaluese janë pa pagesë. Këtë vit shkollor është edhe vakcina kundër gripit gratis!

www.sozialministerium.at

Kush më ndihmon mua, kur e kam harxhuar të gjithë lejen dhe duhet të kujdesem për fëmijën time të sëmurë ?

Mundësia ekzistuese e një leje kujdestarie të veçantë (Sonderbetreuungszeit) deri në tre javë dhe me pagesë do të zgjatet.

<https://www.bmfi.gv.at/>

Kujt mund t'i drejtohem, nëqoftëse dua të flas për problemet që më sjell mua dhe familjes sime COVID-19?

Çdo land i Federatës (Bundesland) ka më shumë se një këshillimore të psikologjisë shkollore, të cilat mund t'i kontaktoni me telefon ose nëpërmjet postës elektronike me e-mail. Ky shërbim është gratis dhe ofrohet në shumë gjuhë.

www.schulpsychologie.at

Kam një pyetje për shkollën ose për COVID-19. Ku mund të informohem?

Ministria (BMBWF) dhe Drejtoria Arsimore (Bildungsdirektion) në landin tuaj kanë caktuar numra të veçantë telefonikë për koronën (Corona-Hotlines). Ja të gjithë numrat e telefonit të përmbledhur:

www.bmbwf.gv.at/hotlines_schule

Në faqen e Ministrisë (BMBWF) mund të gjeni gjithashtu një vështrim të përgjithshëm të aktualizuar për çdo ditë me pyetje dhe përgjigje të shumta për këtë temë.

www.bmbwf.gv.at/corona